Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula _____

Shtojca 8

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;
- c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
- e) Sigurim Oferte sipas kërkesave të ligjit nr .162/2020(shtojca 3/1)

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të ketyre DT (Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit) pikat,1;2;
- Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe vitin 2020 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së takses vendore 2020 për secilin operator).

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Për të provuar përmbushjen e kriterëve ekonomikë e financiarë operatori ekonomik duhet të plotësojë kërkesat minimale si më poshtë duke dorëzuar :

a). Kopje të çertifikuara të bilancit të vitit të fundit ushtrimor (2020) të paraqitur në autoritetet përkatëse , Administrata Tatimore dhe të konfirmuara nga ky autoritet, të cilat duhet të rezultojnë pa humbje sipas kërkesave të legjislacionit fiskal në fuqi.

b). Kopje të deklarimit të xhiros vjetore të 3(tre) viteve të fundit ushtrimorë (2018’2019’2020) të leshuara dhe konfirmuara nga autoriteti përkatës kompetent, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më të vogël se 100% e vlerës së fondit limit të prokuruar , përkatësisht në shumën prej

{1'666'250 (njemilion e gjashtëqind e gjashtedhjet e gjashte mije e dyqind e pesedhjetë) lekë pa TVSH

Shenim-Pika 2.2-b) plotësohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

2.3 Për kapacitetin teknik:

Pervoje e meparshme ne levrimin e mallrave:

2.3-1. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme te mallrave të ngjashem, me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo me te vogel se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht jo me pak se **666'500(gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashte mije e peseqind)lekë pa t.v.sh,** dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

a).Kur furnizimi i meparshem i mallrave te ngjashem, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë: **i)**kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: **ii)** faturat tatimore perkatese te konfirmuara për shërbimet e kryera; **iii)**vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e levrimit si dhe vlera e mallrave te furnizuar;

b).Kur furnizimi i mallrave te ngjashem është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik duhet te paraqese: a) faturat tatimore perkatese, te konfirmuara *(ku te shprehen qarte datat, shumat dhe sasia e mallrave te furnizuar,dhe te nenshkruara rregullisht.*

3.1-a)Kandidati Ofertues duhet te paraqesi License Kodi II.4 për “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farnave dhe/ose fidaneve”, leshuar nga autoriteti kompetent (te vlefshme).

4- Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër te furnizoje/transportoje dhe te dorezoje mallin objekt kontrate, ne vendet e percaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij qe ka ne dispozicion sipas kerkeses se AK.(Deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise) brenda afatit te levrimit .

5.Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesi Certifikatat e Standartizimit si vijon te vlefshme :

- **ISO 9001:2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) E vlefshme (Ne rast te dorezimit te ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike , cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO sipas zerave te mallrave qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marreveshjes).
- **ISO 14001:2015** (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) E vlefshme. (Ne rast te dorezimit te ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike , cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO sipas zerave te mallrave qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marreveshjes).

Shënim: Çertifikatat e mesiperme/ekuivalentet duhet te jene te leshuara nga Institucione te certifikuara/akredituara ne Shqiperi ose tek ato nderkombetare.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti : Furnizim , mbjellje drure dhe shkurre dekorative ne territorin e Bashkise Kruje

- Bliri (Tilia platyphyllos, Scop) fidanet lartesi 4 ml; diam. 16-18 cm me buke dheu

Lloj i familjes se blireve qe shkon deri 25 m I larte ,me simetri te thjeshte, me gjethe te renshme ne trajte zemre nga poshte ne te gjithe siperfaqen me push te imet,lulesa 2-5 lule te bardhereme, fruti nje sferë me push 8-10 mm qe piqet ne tetor .rretitet ne gjithe europen ,siberi etj , ne shqipere rritet kudo i perzier ne zona 300-1200 mmbi nivelin e detit dhe me shume si dru zbukurues.Jeton deri 200 vjet, lulet jane me ere te kendshme dhe perdoren nga mjekesia popullore,arat permbajne rreth 12 % si ai I bajames.

- Rrap (platanus orientalis L) fidanet 4-5 ml; 18-22 cm me buke dheu

Lloj qe I perket Familje monotipike d.m.th vetem nje gjini,gjinia Rrap (Platanus) qe perfshin 6-7 lloje druresh.Lloj zbukurimi qe rritet 40-50m., trunq te trashe me degë të gjera, me gjethe të mëdha me gjethe te medha ne formen e pellembe qe ben lende te vogla me gjemba te imet origjina nga amerika e veriut. Rrapi mund të rritet deri në 50 metra në lartësi. Këto pemë mund të jetojnë për një kohë të gjatë, janë rezistente ndaj ndotjes, kështu që shpesh mbjellen në qytete përgjatë rrugëve si dhe në parqe.

- Frasheri, (Fraxinus L), fidanet 4-5 ml 16-18 cm me buke dheu

Familja e ulinjve (oleaceae,), i gjinisë së frashërit rritet deri 10 m i lartë e i trashë deri 60 cm, në Shqipëri është i përhapur në lartësitë deri 1700 m. Frasheri i bardhë për lulet e tij të bukura rritet si dru zbukurimi me degët e reja të nyjëtura në ngjyrë hiri, me gjethe të përbëra nga 7-9 fletëza eliptike me bisht të shkurtër me lule ne trajte vile të bardha me erë të këndshme, Lulëzon në prill-qershor, bën fruct një farë me një krah 3-4 cm të gjatë e 7-10 mm të gjerë, piqet në tetor. pëlqen klimë malore të ngrohtë toka të freskëta, por rritet dhe në toka të thata qofshin këto edhe gëlqerore. Farat përmbajnë vaj, degët e holla përdoren për të thurur shporta e kosha. Duke bërë

prerje në lëkurën e trungut të F. fitohet një lëng i trashë me shije të ëmbël që quhet manë, përdoret në mjekësi si purgativ.

- *Ilex aquifolium* fidanet me lartësi 5-6 ml 18-22 cm me buke dheu

Akifoliumi *Ilex* është një kaçubë ose pemë e vogël me rritje të ngadaltë, që rrallë i kalon 10m. Gjethet janë rreth 5-8cm të gjata, jeshile të errët me shkëlqim dhe lëkure. Në pjesët e poshtme të bimës ata kanë gjemba përgjatë kufirit duke treguar lart dhe poshtë në mënyrë alternative. Gjethëzat në gjymtyrët e sipërme të bimës, mbi nivelin e kullotjes, janë zakonisht më të butë. Lule të bardha shfaqen në maj, manaferrat shfaqen në bimët femërore rreth nëntorit, duke pjekur të kuqe dhe duke siguruar një burim të mirë ushqimi për zogjtë.

- *Liguster* (*Ligustrum* L) fidanet me lartësi 4 ml 16 - 18 cm me buke dheu

Ligustra apo e njohur ndryshe edhe si voshtër kineze apo voshtër e ndritshme është një lloj bime dekorative e gjinisë *Ligustrum*, në familjen e ullirit. Prejardhjen e ka nga [Kina](#) dhe tashmë rritet e kultivuar si bime dekorative në shumë vende mesdhetare. Rritet deri në 10 m dhe ka gjethë me ngjyrë të gjelbër të errët, me shkëlqim. Lulet i ka në tufa e të bardha, me aromë të fortë, dhe prodhon shumë fruta të vegjël të vendosur në tufa.

- *Pisha Leyland* (*Lajlandi Cypress*) fidane lartësi 3 ml me buke dheu

Lajlandi cypress 15 m deri 16 vjet kryesisht zbuluruese dekorative me origjinë nga Amerika e veriut me rritje të shpejtë vjetore përdoret në plantacione të thyerjet e ëra si dhe zbulon paisazhin me gjethet rreth 1 mm të gjata jeshile të errët disi me të zbehtë në pjesën e poshtme, dhe afër degës, paraqiten në degë të lehta pak aromatike. Levorja e drurit është e kuqe e errët ose kafe dhe ka brazda të thella.

- *Ilqe* (*Quercus Ilex*) fidanet me lartësi 4-6 ml 16-18 cm me buke dheu

Dushku i ahut është gjethë spirale, me margina lobuese në shumë lloje. Është bime monoike, lartësia arrin deri 25 m diametri deri 1 m, levorja e lemuar, e shndritshme me ngjyrë të hinjte të murrme, kercelli jo shumë i gjatë dhe i trashë në baze, disa kanë gjethë të dhëmbëzuara të qendrueshme 2-3 vjet të thjeshta të kembyera dallohet për të qenë me gjelbërime të përjetshme. bisqet ngjyrë hiri me push. Gjithashtu, lenat përmbajnë acidin tannic, ashtu si gjethet. Fruti (lëna) është një arrë deri 4 cm ngjyrë e murrme. Rritet në zonën lauretum (dafinës), përshkruhet me larmishmëri të madhe tokash, tolerues ndaj thatësirës. Dhe ndaj ndotjes urbane, përdoret si rrethues i gjelbërë quajtur një gjilpërë ose një lisi prej lisi që del në një strukturë me filxhan të njohur si një kupolë; përmban një farë (rrallë dy ose tre).

- *Loropetalum* (*Loropetalum chinense*) fidane 15-20 cm me buke dheu

Shkurre kineze *loropetalum* shkon nga emri alternativ i zakonshëm, "lule periferike". Të dyja këto emra dhe emri botanik i referohen pamjes së lulëzimeve të bushit, petals (*petalon*, në greqisht), të cilat i ngjajnë flokëve ose shiritave të vegjël (*loron*, në greqisht). Është një pamje interesante, por kultivatorët e rinj si Ruby ofrojnë më shumë ngjyra. Klasifikohet shkurre *kroate loropetalum* si *chinense Loropetalum*.

Ky është një rast ku emri botanik përdoret zakonisht si emër i zakonshëm. *Loropetalum* i kinez është një shkurre [me gjelbërime të përhershme](#), me shumë rrjedhje të varietetit të [gjethegjerë](#). Kjo shkurre është në familjen e magjistarëve. Shkurre mban grumbuj të luleve aromatike në pranverë. Por është varieteti i *rubrumit*, me lule të kuqerremte ose rozë, që e ka bërë këtë bush

të popullarizuar në peizazh. Llojet e *rubrumit* janë të njohura jo vetëm për lulet e tyre, por edhe për ngjyrën e gjethëve të tyre.

- *Pittosporum* (*Pittosporum Tobire*) fidane 15-20 cm me buke dheu

Shkurre dekorative ,bime bordure. Bime teper interesante dhe rezistente me gjelberim te perhershëm me gjethë jeshile, teper e shpejte ne rritje dhe me kurore te dendur. Bime shume e pershtatshme per zonat me gjysem fije ose qe kane pak drite .

- Fotinija (Photinja red robin) fidane 50 -70 cm me buke dheu

Bime dekorative 1.5-2 m gjethë jeshile dhe te kuqe një [kaçubë me gjelbërim të përhershëm](#) që përmban gjethë të reja të kuqe që dallojnë me gjethë të gjelbër të vjetër. Lule të bardha prodhohen në pranverë nëse shkurre nuk është shkurtuar më parë gjatë sezonit. Mund të shkelet në një gardh ose të formohet në një pemë. Dy llojet që kaluan për të krijuar këtë shkurre janë *Photinia serrulata* dhe *Photinia glabra* .Kjo është një pjesë e familjes Rosaceae, Emrat e Përbashkët Emrat që lidhen me këtë specie përfshijnë fotininë, fotinën e kuqe të tipit, fotinën Fraser, fotinën e kuqe, majën e kuqe dhe majën e kuqe.Tipi i kuq i fotinës është një mundësi për peizazhin .Tipi i kuq i fotinës është një zgjedhje e zakonshme për [mbrojtjet](#) ku krasitja e nevojshme për të ruajtur formën do të shkaktojë formimin e vazhdueshëm të gjethëve të kuqe të reja.

- *Viburno* (*Viburnum*) fidane lartesi 50-70 cm gjeresi deri 70 cm me buke dheu

Viburnum si kaçubë ombrelloreme Gjethë jeshile kanë qenë prej kohësh një nga shkurret më të njohura të peizazhit me lulëzim, me më shumë se 150 specie të disponueshme, duke përfshirë shkurre gjetherënëse, me gjelbërim të përvetshëm dhe gjysmë të gjelbër., kaçubë ose pemë, vendase ose ekzotike. Për shumicën e shkurreve, kohët e lulëzimit shtrihen nga pranvera e hershme deri në qershor, e ndjekur nga fruta tërheqës dhe gjeth i jashtëzakonshëm i vjeshtës.

- *Prunus* (*Prunus laurocerasus*) fidane lartesi mbi 70 cm me buke dheu

Prunus laurocerasus është një kaçubë me madhësi të mesme që i përket familje Roaceae. E njohur i dafina e qerhië, dafina e lëmuar, dafina mbretër, një kaçubë shumë e degëzuar me gjethë jeshile me gjelbërim të përhershëm, ovale, lëkure, të ndritshme me kufij pak të dhëmbëzuar. Lulet pentamerike dhe aktinomorfe janë të grupuara në tufë lulësh të gjata boshtore, fruti është pemë e zezë me shkëlqim të vogël kur piqet, një bimë me rritje të shpejtë që përdoret si bimë zbukuruese për të formuar mbrojtje. Në terren përdoret për të formuar barriera të erës dhe nënshartesës, në parqe dhe sheshe mbillet në grupe të vogla ose si ekzemplarë të vetëm.

- *Feijoa* fidane lartesi mbi 70 cm me buke dheu

Një specie me gjelbërim të përhershëm, ne forme shkurre; në zonën e origjinës arrin 8 metra lartësi Gjethë gri e erret me fruta.Lulet hermafrodite janë shumë terheqese dhe të ngrënshme. Vegjetacioni i bimes fillon rreth muajit Mars; pas rreth 2 muajsh, lulet e para shfaqen dhe lulëzimi mund të zgjasë nga një deri në dy muaj. Jeta e një bime mund të kalojë 70 vjet. Habitatat ideal është ai i kultivimit të ullirit. Nuk mund të qëndrojë në temperatura të ulëta 7 ° C nën zero. Përshtatet mirë për tokat e lehta dhe pa lageshtire.

- Bush jeshil fidane lartesi 50- 70 cm diametri 50 cm me buke dheu

Një shkurre e zakonshme në toka të thata e gëlqerore deri në 1600 m., pema e bushit, për bukurinë e kurorës së saj, është përdorur që në lashtësi edhe si pemë zbukurimi. Kjo pemë rritet në lartësi 5-6 metra dhe jeton 200-300 vjet. Druri i saj, që ka një ngjyrë të verdhë në të çelët, ka cilësi të larta fizike e mekanike. Për vetitë e tij të larta, druri i bushit përdoret në industri për të përgatitur objekte speciale si p.sh. boshte, pajisje që kërkojnë qëndrueshmëri të mirë, si edhe çibukë, kuti etj. Me dru prej bushi bëhen edhe disa vegla muzikore, si p.sh. flaute, fyej et .jBushit përdoret për uljen në përgjithësi të temperaturës së shkaktuar nga pezmatimet e rrugëve të tëmthit dhe të urinës, si dhe për uljen e tensionit të gjakut; nga jashtë përdoret në podagër, në sëmundje të lëkurës dhe reumatizëm.

- Abelia fidane me lartësi 50- 70 cm me buke dheu

Kjo specie, e fituar si rezultat i kalimit të specieve me një lulëzuar dhe kineze, kaçubë dekorative. Ky shkurre konsiderohet gjysmë të përherëshme dhe rritet deri në gati 2 metra.. ka gjethe të formës ovale të gjelbër të errët, pak të theksuar Lule të mëdha shfaqen në tufëzimin e furçës, e cila del nga axils e gjetheve. Lule të kësaj specie kanë pesë petale, pikturohen të bardha, nuk zbehet për një kohë të gjatë dhe erë të këndshme. Lulëzon nga fillimi i verës pothuajse deri në fund të vjeshtës, dhe pas lulëzimit të luleve, zbukurimi i shkurret ruhet falë gota të kuqe dhe marrjes së gjetheve të një ngjyre të veçantë bronzi.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi i pemeve / shkurreve	Njesia	Sasia	Java I	Java II
1	F.mbjellje blin (tilia platyphyllos)16 - 18 cm	Cope	30		
2	Mbjellje bari ne skarpate	M2	500		
3	F.mbjellje rrap (platanus orientalis L) 18 - 22 cm	Cope	30		
4	F.mbjellje frasher (fraxinus L) 16 - 18 cm	Cope	30		
5	Ilex aquifolium 18 - 22 cm	Cope	7		
6	Liguster (ligustrum L)16 - 18 cm	Cope	30		
7	Pisha leyland	Cope	30		
8	Quercus ilex 16 - 18 cm	Cope	10		
9	Loropetalum	Cope	100		
10	Pittosporum	Cope	100		
11	Fotinija (photinia)	Cope	30		
12	Viburno (viburnum)	Cope	30		
13	Prunus laurocerasus	Cope	30		
14	Feijoa	Cope	30		
15	Bush jeshil	Cope	30		
16	Abelia	Cope	20		
17	Lule kacavjerrese	Cope	20		
18	Lule dekorative	Cope	75		
19	Mirembajtje, trajtim sipërfaqje bari	Cope	1		

Mbyllet me nr rendor 19

Afatet e lëvrimit:

Brenda 14(katermbedhjete) diteve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit
Gjelberim dhe mbjellje pemesh dekorative në Bashkinë Krujë

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|----------|-------|
| 2. _____ | _____ |
|----------|-------|

Dokumentat Standarde të Tenderit
Gjelberim dhe mbjellje pemesh dekorative në Bashkinë Krujë

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____ *Emri i plotë i shoqërisë* _____ *numri i NIPT-it* _____
2. _____ *Emri i plotë i shoqërisë* _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____ *Emri i plotë i shoqërisë* _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____ *Emri i plotë i shoqërisë* _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

- tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.

- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe pakeluar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe pakeluar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës.
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
